



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I EKONOMISË FINANCË BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE
PLANIFIKIMIT TË ZHVILLIMIT STRATEGJIK

Nr. 989 prot.

Fushë-Arrëz, më 27.03.2026

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË
FUSHË-ARRËZ

Relacion i Komisionit të Ekonomisë Finance Buxhetit Mbiqyrjes Financiare Planifikimit të Zhvillimit Strategjik mbi Raportin vjetor të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, u mbledh sot më, 27.03.2027, Komisioni i Ekonomisë Finances Buxhetit dhe Mbiqyrjes Financiare me anetare : Franc Doda (Kryetar i komisionit), Besjana Marku (Sekretare e Komisionit), Zef Cara (Anetar i Komisionit), Valentin Doci (Anetar i Komisionit), Valentina Lleshaj (Anetare e Komisionit).

Mbi Raportin i dha shpjegimet Znj. Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak:

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vetë këshilli.

Më poshtë po paraqesim disa nga aktivitetet e Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz për vitin 2025.

Vendimmarrja

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 36 (tridhjetë e gjashtë) mbledhje komisionesh me pjesëmarrjen e 15 këshilltarëve. Numri më i madh i mbledhjeve të komisioneve është ai i komisioneve të përhershme me 34 (tridhjetë e katër) mbledhje dhe 2 (dy) mbledhje për komisionet e tjera të cilat janë ngritur për probleme të bllokimit të rrugëve dhe ujit të pijshëm e vaditës.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2025, janë marrë 51 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Fushë Arrëz, nga të cilat për 48 vendime është shprehur pozitivisht për ligjshmërinë Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër dhe 3 Vendime janë kthyer për rishqyrtim.

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me ndihmën ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % me rreth 23.5 %, pastaj vijnë vendimet në lidhje me buxhetin sipas fazave të programit buxhetor 2026-2028.

Mund të përmendim si vendime kryesore gjatë vitit të kaluar:

1. Vendimet për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 sipas fazave.
2. Vendimet për ndryshime në buxhet.
3. Vendime për të dhënat buxhetore.
4. Vendimi për Paketën Fiskale.
5. Vendimet për Planet e Menaxhimit siç janë, Plani i Mbarështimit të Pyjeve, Plani i Menaxhimit të Mbetjeve, Plani Social Vendor, Plani i Arsimit Parauniversitar, Plani Vendor i Integritetit, Plani Vendor i Barazisë Gjinore.
6. Vendimet për bursat e nxënësve që studiojnë në shkolla profesionale.
7. Vendimet për titujt e nderit.
8. Vendimet për dhënie pronash në përdorim.
9. Vendimet për prioritetet e investimeve në vepra publike.

Gjatë mbledhjeve të këshillit kanë marrë pjesë mesatarisht 11 këshilltarë (rreth 73.3%). Mbledhjet frekuentuar nga 54-94 % e këshilltarëve të shumtën e herëve. Nëse ka pasë ndonjë rast të mungesës së ndonjë këshilltari në mënyrë të përsëritur, arsyet kanë qenë të forta.

Gjithë dokumentacioni i projektvendimeve të shqyrtuara gjatë mbledhjeve të Këshillit është publikuar në faqen web të këshillit për tu dhënë mundësi qytetarëve të njihen me to.

Në regjistrin online për transparencën e mbledhjeve të këshillit janë të dokumentuara të gjitha informacionet mbi mbledhjet duke filluar nga thirrja e mbledhjes, oraret e mbajtjes, videot e mbledhjes dhe procesverbalet tyre. Mbledhjet e Këshillit janë transmetuar online në facebook të Këshillit Bashkiak. Këshilli Bashkiak do të vazhdojë të transmetojë mbledhjet livestream në facebook të mundësuar nga bashkëpunimi me projektin Bashki të Forta (financuar nga Qeveria Zvicerane). Gjithashtu mbledhjet e Këshillit i gjeni edhe në kanalin YouTube të Këshillit Bashkiak <https://www.youtube.com/channel/UC1-psQJMsbpQouhMxVTKTgA/>

Këtu gjejmë rastin të falenderojmë Projektin “Bashki të Forta” për gjithë asistencën teknike dhe operacionale.

Kjo i jep Këshillit Bashkiak një pavarësi në transmetimin pandërprerje livestream të mbledhjeve dhe i krijon mundësi të jetë transparent në lidhje me të gjitha vendimet që merr dhe problemet që trajton për ti ardhur në ndihmë qytetarëve.

Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve

Në Këshillin Bashkiak Fushë Arrëz për periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë regjistruar 12 (dymbëdhjetë) kërkesa të gjitha të marra në konsideratë dhe trajtuar në Këshill Bashkiak. Pjesa më e madhe kërkesave ka qënë për pastrim rrugësh, mungesë të ujit të pijshëm, hapje rrugësh,

poblematika me rendet e ujit vaditës etj. Të gjitha kërkesat dhe ankesat e qytetarëve janë të pasqyruara në regjistrin fizik dhe atë online të Këshillit.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur peticion dhe nisma të qyterarëve te depozituara në këshill. Këshilli Bashkiak në kordinim me Bashkinë do ti japë përgjigje të gjithë shqetësimeve të qytetarëve me mundësitë që ka në dispozicion. Të gjitha kërkesat dhe ankesat janë të publikuara në regjistrin online të kërkesë-ankesave në faqen web të Këshillit Bashkiak.

Konsultimi me publikun

Këshilli Bashkiak i ka kushtuar vëmendje të veçantë dëgjësive publike për projektaktet për të cilat kërkohet nga ligji. Janë zhvilluar 16 dëgjesa publike për 9 projektakte konkretisht, për Planin Vendor të Integritetit, Planin e Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore Dardhë-Qebik, Plani i Menaxhimit të Mbetjeve, Plani Social Vendor, Plani i Arsimit Parauniversitar, Plani Vendor i Barazisë Gjinore, Plani Vendor për Migracionin dhe Diasporën, Relacioni i PBA 2026-2028, Për Dhënie në përdorim Fondi Pyjor Publik për Energji të Rinovueshme.

Në dëgjesa morën pjesë gjithsej 461 qytetarë, biznese, grupe interesi, anëtar këshilli etj. ku janë dhënë 118 rekomandime në dëgjesa publike nga të cilat, për arsye të fondeve në dispozicion, 36% u morën parasysh nga bashkia dhe pjesa tjetër ka qenë për nevoja që nuk janë kompetencë e bashkisë për zgjidhje si për shembull problematikat me instalimet e ujit të pijshëm dhe çmimin e ujit. Të gjitha informacionet për konsultimet me publikun janë të publikuara në regjistrin online për konsultimet me publikun në faqen web të Këshillit Bashkiak.

	Projektvendimi i konsultuar me publikun	Takimet	Pjesëmarrës	Femra	Rekomandime
1	Plani Vendor i Integritetit	1	37	21	-
2	Plani Social Vendor	1	31	20	3
3	Plani i Menaxhimit të Mbetjeve	1	31	20	4
4	Plani i Arsimit Parauniversitar	1	28	21	3
5	Plani Vendor i Barazisë Gjinore	1	28	21	1
6	Plani Vendor për Migracionin dhe Diasporën	1	28	21	-
7	Dhënie në përdorim Fondi Pyjor Publik për Energji të Rinovueshme	4	106	15	10
3	Buxheti 2026 dhe Programi buxhetor afatmesëm, Projektet e investimeve 2026-2028	5	154	34	78
4	Planit i mbarështimit të ekonomisë pyjore Dardhë-Qebik	1	18	2	20

Aktivitetet kryesore të Këshillit

Gjatë vitit 2025 në kuadër të Projektit Bashki të Forta, financuar nga SDC - Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Qeveria e Suedisë, zbatuar nga Helvetas, Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz, mori pjesë në një tryeze pune ndërmjet Këshillave Bashkiake të Qarkut Shkodër dhe Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e qartësisë institucionale ndërmjet tyre. Në këtë tryezë u diskutua një raport vlerësimi i situatës, hartuar nga IDM në qershor 2025 për 6 këshilla bashkiakë (Shijak,

Shkodër, Lezhë, Mirditë, Dibër, Kukës), ku janë evidentuar problematika të ndryshme në kategorizimin dhe trajtimin e akteve normative dhe individuale, si dhe në cilësinë e dokumentacionit shoqëruar që përcillet për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve të këshillave bashkiakë.

Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz për aktivitetet e vitit 2025 kishte planifikuar të shpenzojë 13422000 lekë për shpërblimet e këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave, për pagat e punonjësve të sekretariatit të këshillit, për kancelari, trajnime etj., nga të cilat 522,000 lekë për realizimin e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak.

Gjatë vitit 2025 janë shpenzuar për Këshillin Bashkiak 93,500 lekë kryesisht për kancelari, dëgjesa publike dhe aktivitete të tjera të Këshillit. Në këto shpenzime përfshihen edhe shpenzimet e transportit të këshilltarëve për të marrë pjesë në trajnime. Këtu nuk përfshihen shpenzimet për honoraret e këshilltarëve.

Këshilli Bashkiak ka miratur planin e Aktiviteteve, Vendimarrjes dhe Konsultimeve për vitin 2026 të shoqëruar me një buxhet prej 13,538,000 lekë, nga të cilat 157,000 lekë planifikuar për realizimin e aktiviteteve të përfaqësimit institucional të këshillit dhe për vizita studimore.

Këshilli Bashkiak edhe këtë vit ka organizuar fushata advokimi në facebook-un e Këshillit Bashkiak për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje, duke i ftuar qytetarët të bëhen pjesë aktive në dialogun me qeverisjen vendore, të përdorin instrumentet e Këshillit për zgjidhur problemet e tyre. Qytetarët mund të ndjekin mbledhjet online në facebook të faqes zyrtare të Këshillit Bashkiak apo të marrin pjesë në dëgjesat publike për projektakte të ndryshme apo për buxhetin e Bashkisë. Gjithashtu mbledhjet e Këshillit i gjeni edhe në kanalin YouTube të Këshillit Bashkiak.

Anetaret e komisionit, pasi u njohën me materialin, ishin dakord për ta dërguar Raportin për miratim në mbledhjen Plenare të datës 30.03.2026.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

PER KOMISIONIN:

Valentina Lleshaj Krye
Benjana Marku
Franc Doda
Zef Lere
Valentin Dogi

09/26
E. L.
J. L.
H. L.